

# STATUT

## I

### SHOQERISE "PRIMO GROUP" Sh.p.k.

Në Lezhë, sot më 26/04/2021 (dymijë e njëzet e një), ne seline e shoqerise zhvillohet kjo mbledhje në cilesinë e ortakëve të Shoqerisë "**PRIMO GROUP**" sh.p.k, per miratimin e statutit te shoqerise, kokretisht jane prezent si me poshte;

1. Shoqeria "**E&E RRJOLLI**" sh.p.k person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tille prane regjistrimit Kombetar ne QKB, pajisur me Nipt **M17801302V**, me adrese kryesore Rruga Palaj, Fshati Lac, Lac, perfaqesuar nga administratori Z. **Ervis Rrjoli**, me atesi Fran, i datelindjes 28.03.1982, lindur në Laç dhe banues në Laç, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr.**I20328107O**.
2. Shoqeria "**ALBES INVEST**" sh.p.k person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tille prane Regjistrimit Kombetar ne QKB, pajisur me Nipt **M17821501K**, me adrese kryesore Shengjin Rruga e "Plazhit" Godina Nr.35, Kati 1, perfaqesuar nga administratori Z. **Besnik Paluca**, me atesi Prend, i datelindjes 28.02.1982, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhe, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. **I20228193A**.

## KREUI

### KRIJIMI, FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI SELIA, DHE KOHËZGJATJA E SHOQERISË.

Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar "**PRIMO GROUP**" Sh.p.k. ndodhet me Seli ne Lezhë, Shengjin Rruga Kryesore Qender Shengjin, Godine 1 Kateshe, është krijuar sipas kontratës që i bashkëlidhet ky statut i përpiluar në seline e shoqerise dhe nënshkruar nga ortakët:

1. Shoqeria "**E&E RRJOLLI**" sh.p.k person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tille prane regjistrimit Kombetar ne QKB, pajisur me Nipt **M17801302V**, me adrese kryesore Rruga Palaj, Fshati Lac, Lac, perfaqesuar nga administratori Z. **Ervis Rrjoli**, me atesi Fran, i datelindjes 28.03.1982, lindur në Laç dhe banues në Laç, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr.**I20328107O**.

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



2. Shoqëria "**ALBES INVEST**" sh.p.k person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tille prane Regjistrin Kombetar ne QKB, pajisur me Nipt **M17821501K**, me adrese kryesore Shengjin Rruga e "Plazhit" Godina Nr.35, Kati 1, perfaqesur nga administratori Z. **Besnik Paluca**, me atesi Prend, i datelindjes 28.02.1982, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhe, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. **I20228193A**.

E hartojmë këtë Statut te **Shoqërisë "PRIMO GROUP" Sh.p.k**, mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë:

### Neni 1

#### Krijimi

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj.

Emërtimi i shoqërisë është "**PRIMO GROUP**" Sh.p.k

Kjo shoqëri është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

### Neni 2

#### Personaliteti juridik


**Shoqëria "PRIMO GROUP" Sh.p.k**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaket e shoqërisë", te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri ne pjesën e pashlyer te kontributeve te nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbëjnë kapitalin e regjistruar te shoqërisë.

### Neni 3

#### Selia

Ne Lezhë, Shengjin Rruga "Nene Tereza" Qender Shengjin, godina Nr.22, Kati 1 Shengjin, Godine 1 Kateshe, Shoqëria mund te ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



asamblesë se ortakeve.

#### Neni 4

##### Objekti i veprimtarise

Shoqëria do te ketë për objekt te veprimtarisë te saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushën e :

*Tregeti me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore dhe industriale, kozmetike etj, Ndertim, Investim, Ndertimi i objekteve Civil dhe Industriale, Prodhim dhe Tregeti te materialeve te ndertimit, veprimtari ne fushen e Imobiliareve, marrja dhe dhenia me qira e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, Punime ndertimi, instalime impiantesh te ndrysheme, lysterje, patinimi, dyer, dritare etj, Hotel, Kampinxhe, Argetim per femije dhe te rritur, Bar, Restorant, Lavazh, Parkim, Autoservis dhe servis i makinerive te ndryshme, Tregeti elektroshtepiake dhe paisjeve elektronike, Import-Export te gjitha produkteve te lejuara nga legjislacioni, shitje blerje te Automjeteve dhe me qera, Peshkim zenie dhe tregtim peshku, aktivitete ne fushen e sigurise private, sherbim taksi, transport brenda dhe jasht vendit te udhetareve dhe mallrave, agjensi udhetimesh dhe turistike.*

*Prodhim, ambalazhim, tregetim, transport dhe shperndarje Uji natyral, pijeve freskuese dhe produkte ushqimore. Perpunim, import eksport i lendes drusore dhe tregtmi mobilje, hidrosanitare, pllaka, parkete dhe te gjitha materialeve te lejuara ne fushen e ndertimit.*

*Grumbullim, tregtim i materialeve te ndryshme si hekur, alumin, bronx, baker ( te gjitha llojet e skrapeve)*

*Shitje te materialeve plastike. Punime ne hidrocentrale. Punime siperfaqesore te shfrytezimit, prodhimit te materialeve industrial ( zhavorre, gelqeror, ranor) te mineraleve jometalor, metaloreve, me karriere dhe me punime nentokesore. Import kafe, pije dhe produkte ushqimore, rritja dhe mbarshtrimi i kafsheve dhe ngritja e fermave, Agroturizem, Arkitekture dhe aktivitete Inxhinierike projektim dhe konsulence ne fushen e projektimit dhe zbatimit, trajnim dhe kurse ne fusha te ndryshme Hospitality, Turizem etj dhe cdo lloj aktiviteti te lejuar nga ligji.*

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja

Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore mbi 5 vjet.

#### KREU II

ALBES INVEST SHPK  
NIP: M17821501K  
LEZHE

#### KAPITALI



A large, stylized handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end.

A smaller, more compact handwritten signature in black ink, with a few loops and a horizontal stroke.

## Neni 6

### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë** i përbërë nga 2 (dy) kuota dhe zotërohet nga ortakët e shoqërisë përkatësisht:

- 1. Shoqëria "E&E RRJOLLI" sh.p.k, me 50 % te kapitalit ( 50.000 leke) e barabarte me 1 (nje) kuote.**
- 2. Shoqëria "ALBES INVEST" sh.p.k, me 50 % te kapitalit ( 50.000 leke) e barabarte me 1 (nje) kuote.**

Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar e shlyer krejtësisht.

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlere te tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo të drejta).

Ortakë, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës se shoqërisë, ka te drejte t'i kërkojë gjykatës to urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cënimit te këtyre te drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

## Neni 7

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë te kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës se administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak për te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve te kapitalit që

ALBES INVEST SHPK  
NIP T: M17821501K  
LEZHE



përfaqësorë.

Vendimi për ndryshimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

### **Neni 8**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakeve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 9**

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE

#### **Organi Vendimmarrës**



Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratoreve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
  - j) Te gjithë veprimet që kanë të bëjnë me shitjet - blerjet, lidhjet e kontratave me të tretet të çdo lloji, me organet qendrore etj do të kryhen vetëm nga personi apo personat e autorizuar me vendim të asamblesë së ortakeve .
  - k) Kontratat e punës së punonjësve, paga e shpërblimi i tyre do të bëhen nga personi apo persona të autorizuar me vendim të asamblesë së ortakeve.
  - l) Ndarja e fitimit dhe shpërblimi midis ortakeve do të bëhet me vendim të asamblesë së ortakeve.
  - m) Me vendim të asamblesë së ortakeve caktohen personi apo personat që do të përfaqësojnë shoqërinë përpara bankave të çdo niveli që operojnë në Republikën e Shqipërisë, në këtë vendim do të përcaktohet në mënyrë të detajuar kompetencat e personit apo personave që do të veprojnë në emër të shoqërisë me bankat. Edhe administratori i shoqërisë do të hapë 1 llogari apo të kryejë veprime me bankat vetëm me autorizim të asamblesë së ortakeve të shoqërisë.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 10

#### *Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme*

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 dite përparadatës së parashikuar përmbledhjen e asamblese. Kur "asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 11

#### *Kuorumi*

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortaket që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 dite, me të njëjtin rend dite.

### Neni 12

#### *Marrja e vendimeve*

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shndërrimin në një formë tjetër, transferimin e kuotave, emërimin e eksperteve dhe likuidatorëve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme, të cilat janë të vlefshme, kur në të janë të pranishëm **të gjithë ortaket** me të drejtë vote të cilët votojnë me shkresë, apo

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE

E&E  
RRJOLLI  
M17801302V

mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikës 3 te nenit 88 te këtij ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime te vlefshme me votimin pro te 3/4 të ortakeve pjesëmarrës. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave te ortakeve pjesëmarrës, kur në të marrin pjesë ortaket me të drejtë vote të cilët zotërojnë më shumë se 50% për qind te kuotave për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare te shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve; e
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve,
- e) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve; Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 13**

#### ***Administrimi***

Shoqeria do te kete 2 (dy) administrator te cilet do veprojne vec e vec ose te dy sebashku dhe cdo veprim i kryer prej secilit do te kete fuqi te njejte, administratoret do jene si me poshte:

1. **Z. Ervis Rrjoli**, me atesi Fran, i datelindjes 28.03.1982, lindur në Laç dhe banues në Laç, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr.**I203281070**.
2. **Besnik Paluca**, me atesi Prend, i datelindjes 28.02.1982, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhe, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. **I20228193A**.

Te cilet do të ushtrojnë detyrat e administrimit sipas statutit dhe ligjit për një periudhe 5 vjeçare me të drejte ripërtëritje.

### **Neni 14**

#### **Kompetencat**

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE





***Administratori ka te drejte e detyrohet te:***

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësoje shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;
  - d) Të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë se përgjithshme për miratim;
  - e) krijojë një sistem paralajmërimi ne kohen e duhur për rrethanat, qe kercenojne mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare te Biznesit.
  - f) raportoje përpara asamblesë se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - g) Administratori ka te drejte te përfaqësoje shoqërinë përpara organeve te drejtësisë, gjykatës e prokurorisë, organeve te administratës shtetërore qendrore apo lokale, zyrës se tatimeve
- Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit te zakonshëm te shoqërisë.

**Neni 15**


**Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te tretëve, për shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit, apo për faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve te pa miratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrëveshjen, për te përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e përgjithshme te detyrimit te besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryejë detyrat e tij te përcaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirëbesim e ne interesin me te mire te shoqërisë ne tërësi, duke i kushtuar vëmendje te veçante ndikimit te veprimtarisë se shoqërisë ne mjedis;
  - b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetëm për arritjen e qëllimeve te përcaktuara ne këto dispozita;
  - c) te vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për te cilat merret vendim;
  - d) te parandaloje dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo te mundshëm, to interesave personale me ata te shoqërisë;
  - e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LE 7HE



A large, stylized handwritten signature in black ink, written over a horizontal line.

A smaller, more fluid handwritten signature in black ink.

çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne mënyrë te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vlerësimit te informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me to kane realizuar nga këto veprime te parregullta. Administratori ka barrën e provës për te vërtetuar kryerjen e detyrave te tyre ne mënyrë to rregullt e sipas standardeve te kërkuara.

4. Në mënyrë te veçante, po pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet e ,shkaktuara, nëse, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit ,, Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakevekontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon qe shoqëria te vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqëria nuk do te kishte aftësi paguese për te shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejte të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plote te demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund te ndaloje ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit të detyrës.

### Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### Neni 17 Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### Neni 18 Ekspertet

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



Eksperti ka për detyre që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **Neni 19**

Te ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakeve.

### **Neni 20**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";

- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim përemërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatë, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 21**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emërimit të tij.

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



Nëse shoqëria emëron me shume se një likuidues, pervecse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht te drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund te autorizojnënjërin prej tyre te kryeje veprime te një kategorie te posaçme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te tretëve, ne përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohetmbikëqyrjes se ortakut dhe administratorit.

## **Neni 22**

### Baza Ligjore

Shoqëria do të ketë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", te Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 23**

### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

## **Neni 24**

### Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe, u miratua, në parim nen për nen nga Ortaket e shoqërisë tregtar **"PRIMO GROUP" Sh.p.k**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

## **ORTAKET**

Shoqeria **"E&E RRJOLLI" sh.p.k**

Perfaqesuar nga Administratori



Z.Ervis Rrjoli


Shoqeria **"ALBES INVEST" sh.p.k**

Perfaqesuar nga Administratori

Besnik Paluca

**AKT THEMELIM**  
**I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**SHOQERIA "PRIMO GROUP" Sh.p.k**

Në Lezhë, sot më 26.04.2021 (dymijë e njëzet e një), u mor vendimi për themelimin e shoqërisë si më poshtë:

**THEMELUESIT:**

1. Shoqëria "**E&E RRJOLLI**" sh.p.k person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tillë pranë regjistrimit Kombëtar në QKB, pajisur me Nipt **M17801302V**, me adresë kryesore Rruga Palaj, Fshati Lac, Lac, përfaqësuar nga administratori Z. **Ervis Rrjollli**, me atësi Fran, i datelindjes 28.03.1982, lindur në Laç dhe banues në Laç, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr.**I203281070**.
2. Shoqëria "**ALBES INVEST**" sh.p.k person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tillë pranë Regjistrimit Kombëtar në QKB, pajisur me Nipt **M17821501K**, me adresë kryesore Shengjin Rruga e "Plazhit" Godina Nr.35, Kati 1, përfaqësuar nga administratori Z. **Besnik Paluca**, me atësi Prend, i datelindjes 28.02.1982, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. **I20228193A**.

Themelojme sipas kërkesave të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " , si më poshtë:

**NENI 1**

Te krijojmë shoqërinë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "**PRIMO GROUP**" sh.p.k, e cila do të veprime në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901, date 14.04.2008 dhe formalitetet që duhen plotësuar në të.


Kjo shoqëri do të emërtohet "**PRIMO GROUP**" sh.p.k.

**NENI 2**

Shoqëria "**PRIMO GROUP**" sh.p.k. ka Selinë kryesore në adresën si më poshtë:

Në Lezhë, Shengjin Rruga "Nene Tereza" Qender Shengjin, godina Nr.22, Kati 1

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



Shengjin, Godine 1 Kateshe, me adrese elektronike "primogroup@gmail.com" dhe do të ushtrijë veprimtarinë e saj private për një periudhë kohore të papercaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### NENI 3

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e :

*Tregeti me shumice dhe pakice të produkteve ushqimore dhe industriale, kozmetike etj, Ndertim, Investim, Ndertimi i objekteve Civil dhe Industriale, Prodhim dhe Tregeti të materialeve të ndertimit, veprimtari në fushën e Imobiliareve, marrja dhe dhënia me qira e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, Punime ndertimi, instalime impiantesh të ndryshme, lysterje, patinimi, dyer, dritare etj. Hotel, Kampinxhe, Argetim për fëmijë dhe të rritur, Bar, Restorant, Lavazh, Parkim, Autoservis dhe servis i makinerive të ndryshme, Tregeti elektroshtepiake dhe paisjeve elektronike, Import-Export të gjitha produkteve të lejuara nga legjislacioni, shitje blerje të Automjeteve dhe me qera, Peshkim zenie dhe tregtim peshku, aktivitete në fushën e sigurisë private, shërbim taksi, transport brenda dhe jashtë vendit të udhëtarëve dhe mallrave, agjensi udhëtimesh dhe turistike.*

*Prodhim, ambalazhim, tregtim, transport dhe shpërndarje Uji natyral, pijeve freskuese dhe produkte ushqimore. Perpunim, import eksport i lëndës drusore dhe tregtimi mobilje, hidrosanitare, pllaka, parkete dhe të gjitha materialeve të lejuara në fushën e ndertimit.*

*Grumbullim, tregtim i materialeve të ndryshme si hekur, alumin, bronx, baker ( të gjitha llojet e skrapeve)*

*Shitje të materialeve plastike. Punime në hidrocentrale. Punime sipërfaqesore të shfrytëzimit, prodhimit të materialeve industrial ( zhavorre, gelqeror, ranor) të mineraleve jometalor, metaloreve, me karriere dhe me punime nëntokesore. Import kafe, pije dhe produkte ushqimore, rritja dhe mbarshtrimi i kafshëve dhe ngritja e fermave, Agroturizem, Arkitekture dhe aktivitete Inxhinierike projektim dhe konsulence në fushën e projektimit dhe zbatimit, trajnim dhe kurse në fusha të ndryshme Hospitality, Turizem etj dhe çdo lloj aktiviteti të lejuar nga ligji.*

### NENI 4

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë së saj, me vendim të ortakut sipas dispozitave ligjore në fuqi.

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



## NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jete: **100.000 (njqind mije) lekë** e përbërë nga dy kuota dhe i perket ortakeve si me poshte:

1. Shoqëria "E&E RRJOLLI" sh.p.k, me 50 % te kapitalit ( 50.000 leke) e barabarte me 1 (nje) kuote.
2. Shoqëria "ALBES INVEST" sh.p.k, me 50 % te kapitalit ( 50.000 leke) e barabarte me 1 (nje) kuote.

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

## NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrin ortaket.

## NENI 7

Ortaku që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet të njoftojë me parë ortaket e tjerë të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte dhe në kushte të barabarta. Për hollësi të mëtejshme ortaket do të referohen dispozitave të parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008.

## NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori


Proçedura për emërimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

## NENI 9

Shoqëria do të ketë 2 (dy) administrator të cilët do veprojnë veç e veç ose të dy sëbashku dhe cdo veprim i kryer prej secilit do të ketë fuqi të njëjtte, administratorët do jenë si me poshte:

1. **Z. Ervis Rrjoli**, me atesi Fran, i datelindjes 28.03.1982, lindur në Laç dhe banues në

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE



Laç, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. **I203281070**.

- Besnik Paluca**, me atesi Prend, i datelindjes 28.02.1982, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhe, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. **I20228193A**.

Administratoret zgjidhen për një periudhë 5 vjecare me të drejte ripërtëritjeje.

#### **NENI 10**

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme nëse janë miratuar nga ortaket e saj sipas dispozitave të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare në lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave në kapitalin themeltar për Asamblenë e Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme, kompetencave të ortakeve dhe marrjes së vendimeve do të bazohet në statutin e shoqërisë si dhe në Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

#### **NENI 11**

Likuiditet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shënohet kontributi i ortakut. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave të tjera financiare, të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

#### **NENI 12**

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do të ndahet ndërmjet ortakeve mbasi të jete hequr % që do të futet në fondin e rezervës ligjore.

#### **NENI 13**

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Ky Akt Themelimi u përpilua në katër dokumente origjinale me fuqi të barabarte secila, për t'u depozituar në QKB, Degën Rajonale Tatimore, si dhe dy kopje ruhen në dokumentacionin

ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
LEZHE





baze te shoqërisë.

## ORTAKET

Shoqëria "E&E RRJOLLI" sh.p.k

Perfaqesuar nga Administratori


Z.Ervis Rrjoli



Shoqëria "ALBES INVEST" sh.p.k

Perfaqesuar nga Administratori

Besnik Paluca



ALBES INVEST SHPK  
NIPT: M17821501K  
11 E 744 F